



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.10, datë 28/03/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI  
UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT  
“4A-M” SH.P.K, ME VENDNDODHJE, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
MILOT, BASHKIA KURBIN, QARKU LEZHË**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë “4A-M” sh.p.k, “Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor nëntokësor për qëllime industriale”, me vendndodhje, Njësia Administrative Milot, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

– Pusi 1(P1) -X=474682.1;            Y=4616897.3;            Z=50 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar:  $Q= 3.5$  l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 14.5 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 8 m

– Pusi 2 (P2) - $X=474688.1$ ;  $Y=4616901.3$ ;  $Z=50$  m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar:  $Q= 3.5$  l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 14.5 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 8 m

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

$X=474608.9$ ;  $Y=4616903.3$ ;  $Z=48$  m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI I KBUT MAT**

**GJERGJ PRENDI**

